

KONTRATË PËR SHITBLERJEN E KUOTËS

Bledi Bilali, shtetas shqiptar madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, lindur në Shkodër, më 18.04.1976, me numër personal H60418088F (këtu e më poshtë referuar si '**SHITËSI**')

dhe

Gëzim Galiqi, shtetas shqiptar madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, lindur në Shkodër, më 09.06.1969, me numër personal G90609185L

Kliti Hoti, shtetas shqiptar madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, lindur në Shkodër, më 15.04.1970, me numër personal H00415267Ë

Mark Gjeka, shtetas shqiptar madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, lindur në Shkodër, më 03.02.1964, me numër personal G40203133N

ORTU sh.p.k., shoqëria e së drejtës shqiptare, regjistruar më 06.01.2021, me NIPT M16306006U dhe me adresë në Rruga e Selvijave, Shirokë, Shkodër, Zona kadastrale 8595, Nr. Pasurisë 1/93/ND, Volumi 3, Faqe 241, përfaqësuar nga administratori Vlerar Gjylbegaj (këtu e më poshtë referuar si '**BLERËSIT**')

Të cilët duke marrë parasysh se:

- (i) Shitësi është pronar i 1 (një) kuote që përfaqëson 7% të kapitalit të shoqërisë **Intens21 sh.p.k.**, shoqëri e së drejtës shqiptare, regjistruar më 28.01.2021, me NUIS M16328007A, me adresë në Rruga e Hurmave, Shtoj i Vjeter, Rrethina, me nr pasurie 119/73 dhe 119/74, Shkodër (në vijim, "**Shoqëria**")
- (ii) Shitësi është i interesuar të shesë një pjesë të kuotës së vet prej 4% të kapitalit të Shoqërisë;
- (iii) Blerësit janë ortakë të Shoqërisë dhe kanë në pronësi secili nga një kuotë që përfaqëson 18,4% të kapitalit të Shoqërisë.
- (iv) Katër blerësit janë të interesuar për të blerë secili 1% nga 4% e kuotës që është në shitje prej Shitësit.
- (v) Ortakët e tjerë, sipas dokumentit bashkëlidhur, kanë shprehur vullnetin për të mos ushtruar të drejtën e tyre të parablerjes.

bien dakord si më poshtë vijon:

NENI 1 OBJEKTI I KONTRATËS

1.1. Objekt i kësaj Kontrate është transferimi nga Shitësi tek Blerësit, sipas kushteve dhe termave të përcaktuara në këtë Kontratë, i një pjese prej 4% të kuotës së zotëruar nga Shitësi në shoqërinë Intens21 sh.p.k.



- 1.2. Shitësi i shet secilit prej Blerësve dhe secili prej Blerësve blen nga Shitësi $\frac{1}{4}$ (një të katërtën) e pjesës së kuotës prej 4% të nxjerrë në shitje prej Shitësit të barabartë me 1% të kapitalit të Shoqërisë.

NENI 2

ÇMIMI I SHITJES SË KUOTAVE

- 2.1. Çmimi i shitblerjes i tërësisë së kuotës është 1,000,000 (një milion) Lekë. Ky Çmim përfshin të gjitha të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kuota e transferuar.
- 2.2. Secili prej Blerësve detyrohet t'i paguajë Shitësit një vlerë prej 250,000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) Lekë.
- 2.3. Pagesa e çmimit është kryer përmes transfertës bankare para nënshkrimit të Kontratës.

NENI 3

KALIMI I PRONËSISË SË KUOTAVE

- 3.1. Me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Shitësi humb të drejtën e pronësisë mbi 4% të kuotës së tij në kapitalin e Shoqërisë dhe Blerësit bëhen secili pronar i një pjese kuote prej 1% nga pjesa e shitur e kuotës.
- 3.2. Pas nënshkrimit të kësaj Kontrate,
- 3.2.1. Shitësi zotëron një kuotë në kapitalin e Shoqërisë prej 3% (nga 7% përpara kësaj kontrate shitblerje)
- 3.2.2. Blerësit zotërojnë secili nga një kuotë në kapitalin e Shoqërisë me përqindjet e mëposhtme:
- Gëzim Galiqi zotëron një kuotë prej 19.4% (nga 18.4% përpara kësaj kontrate shitblerje)
 - Kliti Hoti zotëron një kuotë prej 19.4% (nga 18.4% përpara kësaj kontrate shitblerje)
 - Mark Gjeka zotëron një kuotë prej 19.4% (nga 18.4% përpara kësaj kontrate shitblerje)
 - ORTU sh.p.k zotëron një kuotë prej 19.4% (nga 18.4% përpara kësaj kontrate shitblerje)
- 3.3. Secila nga Palët mund të procedojë me regjistrimin e kësaj Kontrate në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

NENI 4

DEKLARIMET DHE GARANCITË E SHITËSIT

- 4.1. Shitësi deklaron se kuota është plotësisht të disponueshme, lirisht e transferueshme dhe e lire nga cdo lloj pengu apo barre tjeter ligjore, e lire nga cdo lloj detyrimi apo pretendimi i te treteve të cfaredo natyre dhe nga cdo parregullsi ligjore.



2

- 4.2. Me nënshkrimin e kësaj kontrate, Shitesi zhvishet teresisht nga pronesia mbi pjesën e kuotë së transferuar dhe humbet të gjitha të drejtat e pronesisë mbi pjesën e kuotës së shitur, e cila kalon në pronesi të bleresve sipas përqindjeve të dakordësuara me sipër.

NENI 5 SHPENZIMET DHE DETYRIMET TATIMORE

- 5.1. Shpenzimet apo detyrimet tatimore që mund të lindin për shkak të kësaj Kontrate përballohen nga palët sipas legjislacionit në fuqi.

NENI 6 LIGJI I ZBATUESHËM DHE ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

- 5.2. Kjo Kontratë do të rregullohet, interpretohet dhe zbatohet në përputhje me ligjet në fuqi në Republikën e Shqipërisë.
- 5.3. Çdo mosmarrëveshje apo pretendim që mund të lindë në lidhje me interpretimin, përmbushjen apo zbatimin e kësaj Kontrate ose e lidhur me të, do t'i nënshtrohet për zgjidhje gjyqësore Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

Kjo kontratë është redaktuar në 5 (pesë) kopje në gjuhën shqipe. Kjo kontratë pasi u lexua nga palët, u konsiderua e redaktuar sipas pëlqimit të tyre dhe u nënshkrua me vullnet të lirë e të pavesuar.

Në Shkodër, më 01/08/2024

PALËT

SHITËSI

Bledi Bilali

Bledi Bilali
(Emër, Mbiemër)

(Nënshkrim)

BLERËSIT

Gëzim Galiqi

Gëzim Galiqi
(Emër, Mbiemër)

(Nënshkrim)

Mark Gjeka

Mark Gjeka
(Emër, Mbiemër)

(Nënshkrim)

Kliti Hoti

Kliti Hoti
(Emër, Mbiemër)

(Nënshkrim)

ORTU sh.p.k

përfaqësuar nga

VLERAR GOYBEGAO
(Emër, Mbiemër)

(Nënshkrim)